VENDIM
Nr. 4, datë 22.5.2013

MBI MIRATIMIN E PAGESAVE PËR LICENCË

Në mbështetje të germës "f" të pikës 1 dhe pikës 16 të nenit 19, si dhe pikave 1 dhe 2 të nenit 25 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", Autoriteti i Medias Audiovizive

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesat për licencë si më poshtë:
1.1 Pagesat vjetore për licencë kombëtare transmetimi numerik tokësor

1.1.1 Masa e pagesës vjetore për licencë kombëtare transmetimi numerik tokësor audio
- Pagesë vjetore për licencë transmetimi audio (T-DAB) 1 500.000 lekë.
- Pagesë vjetore për licencë shërbimi programi audio 200.000 lekë.
- Pagesë vjetore për licencë transmetimi audio analoge kombëtare 1.500.000 lekë.

1.1.2 Masa e pagesës vjetore për licencë kombëtare transmetimi numerik tokësor audioviziv
- Pagesë vjetore për licencë transmetimi audioviziv 15.800.000 lekë.
- Pagesë vjetore për licencë shërbimi programi audioviziv 1.700.000 lekë.
- Pagesë vjetore për licencë shërbimi programi audio mbështetur në rrjete numerike audiovizive (DVB-T2) 200.000 lekë.

1.2. Pagesat vjetore për licencë rajonale transmetimi numerik tokësor
1.2.1 Masa e pagesës vjetore për licencë rajonale transmetimi numerik tokësor audio dhe audiovizive dhe audio analoge (1 qark)

Nr.	Zonat	Transmetime audio	Transmetime audiovizive	Pagesa për operatorët audio FM
1	Qark me popullsi deri në 250 000 banorë	60000	700000	21500
2	Qark me popullsi deri në 400 000 banorë	120000	1400000	34300
3	Qark me popullsi mbi 400 000 banorë	140000	1700000	40000
4	Për Tiranën dhe Durrësin	400000	4500000	140000
5	Vetëm për qytetin e Tiranës	60000	---	42300

1.2.2 Masa e pagesës vjetore për licencë shërbimi programi audio dhe audioviziv mbështetur në një rrjet rajonal numerik tokësor (1 qark)

Nr.	Zonat	Transmetime audio	Transmetime audiovizive
1	Qark me popullsi deri në 250 000 banorë	30000	230000
2	Qark me popullsi deri në 400 000 banorë	40000	460000
3	Qark me popullsi mbi 400 000 banorë	88000	560000
4	Për Tiranën dhe Durrësin	250000	1500000
5	Vetëm për qytetin e Tiranës	45000	---

2. Pagesat për licencë transmetimi audio për qëllime të përkohshme dhe institucionale
2.1 Masa e pagesës për licencë transmetimi audio për qëllime të përkohshme

Deri në 1 muaj
Për bashki me popullsi deri në 60.000 banorë 10.000 lekë.

Për bashki me popullsi deri në 70.000 banorë	20.000 lekë.
Për bashki me popullsi deri në 200.000 banorë	30.000 lekë.
Për bashki me popullsi mbi 200.000 banorë, përveç Tiranës	40.000 lekë.
Për rrethin e Tiranës (bashki e rreth)	50.000 lekë.

2.2 Masa e pagesës për licencë transmetimi audio për nevoja institucionale

Për bashki me popullsi deri në 60.000 banorë	10.000 lekë.
Për bashki me popullsi deri në 70.000 banorë	20.000 lekë.
Për bashki me popullsi deri në 200.000 banorë	30.000 lekë.
Për bashki me popullsi mbi 200.000 banorë, përveç Tiranës	40.000 lekë.
Për rrethin e Tiranës (bashki e rreth)	50.000 lekë.

3. Pagesa vjetore për licencë kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet një kamatë vonese në masën 0.1% të vlerës së pagesës vjetore për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 30% e vlerës së detyrimit financiar.

4. Detyrimi sipas pikës 3 të këtij vendimi, nuk zbatohet për subjektet e licencuara për transmetim audio për qëllime të përkohshme. Pagesa për licencë transmetimi audio për qëllime të përkohshme kryhet në momentin e licencimit.

5. Pagesat do të kryhen në llogaritë bankare të AMA-s.

6. Ngarkohet administrata e Autoritetit të Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati